

**AKTI I THEMELIMIT**  
**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“PRENDE “ SH.P.K.**

Në Tiranë, sot me datë 19.04.2018 (dy mijë e tetembedhjete), ortaket themelues:

**Z. Muhamet Gjocaj** i datëlindjes 15.10.1967, lindur ne Baballoq, madhor e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr K00587315, dhe

**Z. Enver Knushi** i datëlindjes 07.07.1968, lindur ne Junik, madhor e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr 1030777731 ne cilesine e ortakve te cilet me vullnet të lirë, të do te ushtrojne aktivitetin si person juridik, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me referendum më 22.11.1998,
- Kodi Civil miratuar me ligjin Nr. 7850. Dt. 29.07.1994 (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 9723, Dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
- Ligji 131/2015 per Qendren Kombetare te Biznesit.
- Si dhe në të gjithë legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

Deklarojme vullnetin për të themeluar shoqërinë tregtare “PRENDE” Sh.p.k, shoqëri e së drejtës shqiptare, të cilën vendos ta themeloje sot më dt 19.04.2018  
Ortaket Themelues vendosen të miratojne Statutin si më poshtë vijon:



STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"PRENDE" Sh.p.k.

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

**NENI 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "PRENDE" sh.p.k, krijohet nga ortaket :

**Muhamet Gjocaj** i datëlindjes 15.10.1967, lindur në Baballoq, madhor e me zotësi juridike e për të vepruar mbajtes i pasaportes me nr K00587315, dhe

**Z. Enver Knushi** i datëlindjes 07.07.1968, lindur në Junik, madhor e me zotësi juridike e për të vepruar mbajtes i pasaportes me nr 1030777731.

**NENI 2**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe nenit 32 të ligjit 9723 datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ". Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; Ligji 131/2015 për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit Tirane.

**NENI 3**

**Emertimi i shoqërisë**

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "PRENDE" sh.p.k. Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit të saj themeltar të paraqitur në këtë statut.

**NENI 4**

**Selia e shoqërisë**

Selia e shoqërisë do të jetë në adresë; "Rruga "Jordan Misja", Pall Sara -El, Ap 1 Tirane .



Shoqëria mund të ketë filjale dhe perfaqësi të saj edhe në rrethet e tjera të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë territorit të saj.

#### **NENI 5** **Objekti i Veprimtarisë**

Do të jetë :

*Import të produkteve kozmetike të gjitha llojeve, Hapje Qender Estetike (Trajtim fytyre, masazhe, shërbim për heqje të celulitit, etj.*

#### **NENI 6** **Kohe zgjatja e shoqërisë**

Shoqëria ka një kohezgjatje të veprimtarisë pa afat. Ajo mund të perfundojë veprimtarinë e saj në çdo kohë në rastet e prishjes ose të likuidimit të shoqërisë

#### **NENI 7** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është caktuar në shumën 100,000 leke (Njëqint mijë leke), kapitali i ndarë në 2 kuota ku secili ortak zotëron 1 (një) kuota të barabartë me 50.000 leke ose 50% të kapitalit.

#### **NENI 8**

Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rrugë trashëgimie.

Me vullnetin e ortakut kapitali themeltar mund të transferohet edhe personave të tretë.

#### **NENI 9**

Ortaku I vetëm i cili është themelues i kësaj shoqërie me vullnetin e tij mund të shtojë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që ai e shikon të nevojshme.

#### **NENI 10**

Ortakët e Shoqërisë janë themeluesit, **Muhamet Gjocaj dhe Enver Knushi.**

#### **NENI 11**

**Asambleja e Ortakëve ka të drejtë :**

- Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Ndryshimet e statutit .
- Emerimi dhe shkarkimi i administratoreve.
- Emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel të autorizuar.
- Percaktimi i shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe eksperteve kontabel të autorizuar.



- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit.
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- Ceshtje te tjera te parashikuara ne ligj apo ne statut.

#### NENI 12

Administrator i Shoqerise do jete znj. Joniada Biçi e datelindjes 12.09.1984 lindur ne Tirane madhore e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtese e leternjoftimit me nr personal I45912046B, per nje afat 5 (pese ) vjecar.

Administratori do te kete keto te drejta e detyrime ;

- Te kryej te gjitha veprimet administrative te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjitheshme ( Ortaku i shoqerise)
- Te perfaqesoje shoqerine tregtare.
- Te kujdeset per mirembajtjen e sakte e te rregullut te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pregatise dhe te nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asambleve se pergjitheshme per miratim.
- Krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- Kryen regjistrimin dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin Per Qendren Kombetare te Biznesit.
- Raporton para asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e polikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.
- Kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

#### NENI 13

Per perfaqesimin e shoqerise perpara organeve shteterore administrative dhe gjyqesore ose te treteve, shoqeria prezantohet nga ortaket e shoqerise.




#### NENI 14

Shoqeria ka vullen e vet. Forma dhe teksti percaktohen nga Asambleja e Ortakeve ne kete rast (ortaket e shoqerise).

#### NENI 15

##### **Bilanci dhe te ardhurat**

Veprimet ekonomike dhe financiare fillojne me 1 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Asambleja e Pergjitheshme cakton nje ekspert te autorizuar i cili ben bilancin e vitit ushtrimor paraardhes me te ardhurat, fitimet dhe humbjet, te formuluar keto konforme ligjit nr. 9228 dt.29.04.2004 " Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Bilanci miratohet nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e shoqerise. Ai depozitohet ne zyren tatimore sipas afatit ligjor.

#### NENI 16

Eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise (Ortakeve te Shoqerise) te vendose per krijimin e fondeve nga te ardhurat neto si dhe perdorimin e tyre sipas nevojave te tij.

#### NENI 17

Kapitali i shoqerise depozitohet ne llogarine e shoqerise prane nje banke private ose shtetore vendase ose te huaj qe vepron ne territorin e Shqiperise. Shoqeria mund te çele llogari bankare ne leke ose ne valute ne nje banke tjeter private apo shtetore vendase ose te huaj, brenda dhe jashte vendit.

#### NENI 18

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie i perket teresisht ortakut te vetem te saj. Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie, kjo shoqeri pergjigjet me kapitalin e saj.

#### NENI 19

##### **Shperberja**

Duke qene se ne çdo kohe per motive te ndryshme shoqeria mund te ndodhet perballe shperberjes, me vendim te ortakve te vetem vendoset per menyren e likujdimit te saj, ne baze te ligjeve ne fuqi.

Likujdimi i shoqerise mund te behet sipas rasteve te parashikuara ne ligji.

#### NENI 20

Per çeshtje qe nuk parashikohen e rregullohen nga ky statut, vlejne dispozitat 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", te ligjit 9723 date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.



NENI 21

Statuti u perpilua ne kater kopje me fuqi te njejte ligjore te cilat do te sherbejne per tu administruar ne organet kompetente tatimore dhe gjyqesore dhe kopjet e tjera mbeten ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE

**Muhamet Gjocaj**

MUHAMET GJOCAJ



**Enver Knushi**

Enver Knushi



**V E N D I M**

**Nr 1 date 19.04.2018**

**I O R T A K V E T E S H O Q E R I S E**

**" P R E N D E " S h . p . k .**

Sot me date 19.04.2018, ne selinë e shoqërisë "PRENDE" SH.P.K me seli ne Rruga 'Jordan Misja , Pall Sara -El , Ap 1 Tirane .

Ne ortakët e shoqërisë **Z. Muhamet Gjocaj** i datëlindjes 15.10.1967, lindur ne Baballoq, madhor e me zotësi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr K00587315, dhe

**Z. Enver Knushi** i datëlindjes 07.07.1968, lindur ne Junik, madhor e me zotësi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr 1030777731 ,

**V E N D O S E M :**

Mbeshtetur ne ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren kombetare te Biznesit" si dhe ligjit 9901 date 14.04.2008"Per Tregetaret dhe Shoqërite Tregetare", I ndyshuar dhe shtuar me ligjin nr 129/2014, Ligji 131/2015 per Qendren Kombetare te Biznesit.

Krijimin e Shoqërisë " **PRENDE** " sh.p.k, me ushtrimin e aktivitetit sipas Akt Themelimit dhe Statutit bashkelidhur .

**O R T A K E T E S H O Q E R I S E " P R E N D E " S H . P . K**

**MUHAMET GJOCAJ**

MUHAMET GJOCAJ



**ENVER KNUSHI**

Enver Knushi



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERVE TIRANE  
NR.....REP

Taksa e palles u pagua



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tiranë sot me date 19.04.2018, ne zyren e noterise Tirane, para meje noteres Rudina Hoxhaj, me adrese ne Rugen "Gjergj Fishta" pallati nr 16, shkalla nr 9, kati i II prane Drejtorise Rajonale te Policise Tirane, u paraqiten personalisht

**Z. Muhamet Gjocaj** i datëlindjes 15.10.1967, lindur ne Baballoq, madhor e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr K00587315, dhe

**Z. Enver Knushi** i datëlindjes 07.07.1968, lindur ne Junik, madhor e me zotesi juridike e per te vepruar mbajtes i pasaportes me nr 1030777731, te cilet paraqiten dhe nenshkruan para meje ne Aktin e Themelimit , Statutin dhe Vendimin e ortakve per krijimin e Shoqerise "PRENDE" sh.p.k.

Une noterja vertetoi nenshkrimin e tij konform ligjit.

NOTERE

RUDINA HOXHAI